



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 98, datë 28.07.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR EKSPERTËT KONTABËL TË
REGJISTRUAR TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 128 të Kodit të Procedurës Administrative, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve në rregulloren “Për ekspertët kontabël të regjistruar të shoqërive të sigurimit”, të miratuar me vendimin nr. 7, datë 08.02.2007, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për ekspertët kontabël të regjistruar të shoqërive të sigurimit”, të miratuar me vendimin nr. 7, datë 08.02.2007, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Në rregulloren “Për ekspertët kontabël të regjistruar të shoqërive të sigurimit”, të miratuar me vendimin nr. 7, datë 08.02.2007, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i rregullores ndryshon si më poshtë vijon:

“Për ekspertët kontabël të regjistruar”

2. Paragrafi hyrës i rregullores pas shprehjes “neni 71,72,73 dhe 74” shtohet fjalia si më poshtë vijon:

“dhe të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, neni 32, 33 dhe 34, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,”

3. Në nenin 1, bëhen këto ndryshime:

Pika 1.1 pas shprehjes “neni 71, 72, 73, 74” shtohet, fjalia si më poshtë vijon:

“Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”; neni 32, 33 dhe 34; ”

Pika 1.2 ndryshohet, si më poshtë vijon :

“Subjekte të kësaj rregullore janë:

- a) shoqëritë e sigurimit dhe degët e shoqërive të huaja, të licencuara ose që janë në proces licencimi nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të kryer veprimtari sigurimi ose risigurimi në Republikën e Shqipërisë dhe;
- b) shoqëritë administruuese të fondeve të pensionit dhe degët e shoqërive të huaja, të licencuara ose që janë në proces licencimi nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të kryer veprimtari në Republikën e Shqipërisë.”

Pika 1.3 në germën a) pas shprehjes “dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime” shtohet fjalia si më poshtë vijon:

“dhe Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”;

“Në germën b) të Pikës 1.3, pas shprehjes “Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004;” shtohet fjalia si më poshtë vijon:

“Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 2009 “Për fondet e pensionit vullnetar””

4. Në nenin 4, bëhen këto ndryshime:

Pika 4.1 pas fjalëve “ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime;” shtohet fjalia, si më poshtë vijon:

“Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar””

Pika 4.3 riformulohet, si më poshtë vijon:

“4.3 Mbi bazën e ekzaminimit të bërë, shoqëria e ekspertëve kontabël të regjistruar jep një opinion, duke vënë në dukje nëse raportet financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të raporteve financiare apo kërkesave të tjera të Autoritetit sipas parashikimeve të pikave 4.1 dhe 4.2 të po këtij neni.”

5. Në nenin 8, bëhen këto ndryshime:

Pika 8.3 pas fjalëve “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime e risigurime”, shtohet fjalia si më poshtë vijon:

“dhe neni 7, të rregullores nr. 25, datë 23.02.2011 “Për raportimin në AMF të veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit”.

6. Shprehja “shoqëri sigurimi” në të gjithë rregulloren zëvendësohet me fjalën “Shoqëri”.